



## **Procedura dhe dokumentacioni ne rast te Ndodhjes te Ngjarjes te Sigurimit**

### **Njoftimi I Ngjarjes te sigurimit**

Përfituesi ose i siguruari detyrohet që me ndodhjen e rastit të sigurimit të njoftojnë me shkrim Siguruesin brenda 7 ditësh nga dita e ngjarjes.

### **Prova e dëmtimit/humbjes**

Prova me shkrim e dëmtimit / humbjes duhet t'i jepet Siguruesit sa më shpejt të jetë e mundur, brenda 30 ditësh nga Njoftimi i Dëmtimit/Humbjes, së bashku me kopjet origjinale të të gjithë dokumentacionit përkatës.

Personi i Siguruar ose Policëmbajtësi ose Përfituesi me shpenzimet e tij, do të t'i dorëzojnë Siguruesit në formën e kërkuar prej tij ato certifikata, informacione dhe të dhëna që Siguruesi do të kërkojë.

Siguruesi do të ketë të drejtën por jo detyrimin që, me shpenzimet e tij, t'i kërkojë Personit të Siguruar të kryejë kontrolle mjekësore sa herë të jetë e nevojshme gjatë periudhës së trajtimit të një kërkesë për dëmshpërblim/përfitim.

**Ne rast te humbjes te jetes te te siguruarit** njoftimi bëhet me formularin përkatës të Siguruesit dhe bashkë me të paraqiten dokumentat e mëposhtme:

- Origjinali i policës së sigurimit të jetës dhe të kartës personale të sigurimit;
- Kopje të dokumentit të identifikimit;
- Çertifikatën e vdekjes
- Skeden e Vdekjes
- Epikriza mjekësore të leshuar nga mjeku specialist që ka ndjekur dhe kuruar të siguruarin, ku të përfshihen historiku sëmundjes, koha e diagnostikimit të sëmundjes, shkaqet, shtrimet në spital, komplikacionet, sëmundjet e tjera nga i cili vuan i siguruarin, trajtimin mjekësor, rekomandimet etj (firmosur nga mjeku, vulosur nga mjeku dhe institucionit shëndetësor)
- Dëshmi trashëgimie nëse si përfitues të policës janë përcaktuar trashëgimtarët e ligjshëm;

Siguruesi ka të drejtë të kërkojë dhe prova të tjera mjekësore/ligjore të nevojshme për vërtetimin e të drejtës për pagesë. Shpenzimet që kanë të bëjnë me njoftimin e ngjarjes së sigurimit janë në ngarkim të personit që bën njoftimin.

**Ne rast "Paaftësi e Plotë/e Pjesëshme e Përhershme" si rrjedhojë e një aksidenti** njoftimi bëhet me formularin përkatës të Siguruesit dhe bashkë me të paraqiten dokumentat e mëposhtme:

- Kopje e leternjoftimit
- Fletedrejtimi për ne KEMP
- Vendimi i Komisionit Mjekësor të Aktimit të Paaftësisë në Pune (KMCAP) që cakton paaftësinë e plote të përhershme dhe shkaqet e saj.
- Dokumenta të tjerë mjekësorë/ligjorë nëse është e nevojshme, përfshirë por pa u kufizuar:
  - Kopje e karteles të shtrimit në spital nëse është shtruar në spital

- Procesverbal i Policise ne lidhje me aksidentin
- Vendim i Prokurorise lidhur me ngjarjen

Siguruesi mund të kërkojë dokumentacion dhe prova më të detajuara në lidhje me shkallën e paaftësisë dhe shkaqet e saj

**Ne rast “Paaftësi e Përkohshme” si rrjedhojë e një aksidenti** njoftimi bëhet me formularin përkatës të Siguruesit dhe bashkë me të paraqiten dokumentat e mëposhtme:

- Kopje Leternjoftimit
- Epikriza mjekesore të leshuar nga mjeku specialist që ka ndjekur dhe kuruar të siguarin, ku të pershkruhen historiku sëmundjes, koha e diagnostikimit të sëmundjes, shkaqet, shtrimet në spital, komplikacionet, sëmundjet e tjera nga i cili vuan i sigururari, trajtimin mjekësor, rekomandimet etj (firmosur nga mjeku, vulosur nga mjeku dhe institucionit shëndetësor)
- Raportet e paaftësisë të përkohshme
- Dokumenta të tjerë mjekësorë/ligjorë nëse është e nevojshme, përfshirë por pa u kufizuar:
  - Kopje e karteles të shtrimit në spital nëse është shtruar në spital
  - Procesverbal i Policise në lidhje me aksidentin
  - Vendim i Prokurorise lidhur me ngjarjen

Siguruesi mund të kërkojë dokumentacion dhe prova më të detajuara në lidhje me shkallën e paaftësisë dhe shkaqet e saj.